

NJOFTIM nr 2

PËR MARRJEN ME QIRA TË PASURISË NGA TË TRETËT PËR USHTRIM AKTIVITETI DOGANOR NGA DEGA DOGANORE KORÇË

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton të interesuarit/konkurrentët se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë doganore të Degës së Doganës Korçë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - Të jetë sipërfaqe rreth 5294 m², e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë doganore prej te cilave sipas nëndarjeve duhen:
 - Sipërfaqe ndërtesë 94m² ;
 - Sipërfaqe truall për vendosje platformë peshore 150 m² ;
 - Sipërfaqe magazinë 50 m² ;
 - Sipërfaqe truall për parking doganor 5000 m² ;
 - Vendndodhja e ambjenteve të jetë në afërsi të aksit Kombetare Korçe-Kapshtice, lehtësisht e identifikueshme dhe objekti të ketë ambiente të përshtatshme për zyra, parkim automjete dhe për agjensi doganore;
 - Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbarëvajtjen punës.
 - Duke u nisur nga rëndësia e Institucionit të jetë e përshtatshme për ruajtjen e sigurisë së ambjenteve;
 - Të jetë një objekt qëllimi i të cilit të jetë kryesisht për ambiente pune;
 - Në objekt të jetë i siguruar furnizimi pa ndërpreje energji elektrike, të ketë sistem ngrohje të instaluar ;
 - Objekti të jetë i hipotekuar dhe të ketë një plan rievilimit të hartuar nga një inxhinjer/subjekt i licencuar;
 - Të jetë një ndërtesë lehtësisht e përshtatshme për ambiente pune, pasi Dega Doganore Korçë nuk disponon fonde për përshtatjen e saj për zyra;
 - Vlera fillestare për konkurrim është **2,422,351.01** lekë (dy milion e katërqind e njëzet e dymijë e treqind e pesëdhjete e një pikë zero një) lekëreferuar VKM-së 469 datë 03.06.2015.

2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:
 - a. kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;
 - b. deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit, për veprimtari doganore;
 - c. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
 - d. formulari i sigurimit të ofertës në vlerën 2% të VFQ. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 100 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
 - e. vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka subjekti konkurrues. Mosshlyerja e detyrimeve

të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e konkurruesit, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.

- f. NIPT/NUIS-i, certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- g. vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- h. vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Ky dokumentacion tëparaqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga konkurruesi, me mbishkrimin *“Ofertë për dhënie me qira”* dhe i dorëzohet KMQ në orën e hapjes së konkurrimit

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërmepërbën kusht skualifikues.

- 3. Vendi i zhvillimit të konkurrimit: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zyra e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, me adresë:
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE,
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1, Rr. Industriale, Pajtoni Center, kati 5
- 4. Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët fizikisht, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.
- 5. Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese:08/07/2020.